



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 45, datë 29.04.2020

**“PËR
NISJEN E PROCEDURAVE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË
“NDËRMARRJA E TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NR. 3” SH.A NGA SHOQËRIA
PËRTHITHËSE “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1”, SH.A
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, vendimit nr.335, datë 04.05.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca Studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i Studentëve nr. 2” sh.a. Tiranë dhe “Trajtimi i Studentëve nr. 3 “ sh.a. Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes tek Bashkia Tiranë”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Rezidenca Studentore nr. 1” sh.a., dhe shoqërisë “Trajtimi i Studentëve nr. 3 sh.a,

V E N D O S I :

1. Nisjen e procedurave të bashkimit me përthithje ndërmjet shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtitit të Studentëve nr. 3” sh.a. si shoqëri e përthithur dhe shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1” sh.a, si shoqëri përthithëse.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, ngarkohen përfaqësuesit ligjorë të shoqërive aksionare të ndjekin procedurat e bashkimit duke u përjashtuar nga detyrimi për zbatimin e përcaktimeve të nenit 217, pika 5 e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” të ndryshuar.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, shoqëria “Ndërmarrja e Trajtitit të Studentëve nr. 3” sh.a, dhe shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”sh.a për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

TONI GOGU
